

**MBI NDËRHYRJET NË TREGUN E PARASË DHE NË TREGUN VALUTOR
GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2021**

1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2021

1.1. Operacione të tregut të hapur dhe faktorët që kanë ndikuar mungesën e likuiditetit në sistemin bankar

Tabelë 1: Veprimet e përkohshme të tregut të hapur (në miliardë lekë¹.) Burimi: Banka e Shqipërisë

DATA	R/REPO njëditore	R/REPO njëjavore	R/REPO >1javë <3muaj	REPO Njëditore
1-Prill-21		20.88		
8-Prill-21		21.19		
15-Prill-21		20.40		
22-Prill-21		27.29		
26-Prill-21			4.65	
29-Prill-21		20.90		
06-Maj-21		15.25		
14-Maj-21		17.32		
20-Maj-21		23.64		
24-Maj-21			5.67	
27-Maj-21		17.28		
3-Qershor-21		10.35		
10-Qershor-21		12.76		
17-Qershor-21		20.15		
24-Qershor-21		22.81	5.06	

Në tremujorin e dytë të vitit 2021, ndërhyrjet e BSH-së në tregun e parasë konsistuan në operacionet e tregut të hapur për injektim likuiditeti.


Injektimi mesatar ditor nëpërmjet operacioneve injektuese të likuiditetit me maturim 1-13 javë, ka qenë 34.80 mld lekë, me një rritje të lehtë krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm ku rezultoi në nivelin prej 33.40 mld lekë.

Gjatë kësaj periudhe, kërkesa e bankave për likuiditet në operacionet e Bankës së Shqipërisë është luhatur në bandën e gjerë 26.10 - 43.70 mld lekë, por rritja mbi 40 mld lekë ka qenë momentale në periudhën midis 2 periudhave të rezervës së detyrueshme. Nevoja për likuiditet e bankave ka qenë 37.30 mld lekë në fillim të periudhës dhe 38.20 mld lekë në fund të saj, ku efekti nga rritja e parasë në qarkullim për shumën kumulative 8.60 mld lekë, është kompensuar kryesisht edhe nga injektimet e Bankës së Shqipërisë nëpërmjet blerjeve të valutës në tregun valutor për 5 mld lekë, gjatë ankandeve të zhvilluara në tremujorin e dytë . Në funksion të operacioneve për administrimin e likuiditetit të sistemit bankar, Banka e Shqipërisë, ka përdorur instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim një javor për mesatarisht 19.20 mld lekë.

¹ Shifrat janë në vlerë likuiditeti

Në përputhje me vendimin e KZKPM, nga java e dytë e muajit mars 2020, Banka e Shqipërisë ka ndryshuar formën e ankandit nga “ankand me shumë të fiksuar” në “ankand me çmim uniform” ku bankat mund të marrin hua shuma të pakufizuara me normë interesi të njëjtë me normën bazë. Vendimi ka synuar uljen e pasigurisë në sistemin bankar për gjendjen e likuiditetit në çdo bankë. Kjo formë ankandi ka vijuar edhe gjatë këtij tremujori .

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë në periudhën 2016-2021 (me vlerë nominale). Burimi: Banka e Shqipërisë




1.2 Përdorimi i operacioneve lehtësuese të përhershme

Sistemi bankar ka përdorur instrumentin e depozitës në BSH në mënyrë të vazhdueshme për mesatarisht 7.00 mld lekë . Instrumenti i kredisë njëditore nuk është përdorur në asnjë rast.

1.3 Operacionet strukturore për menaxhimin e likuiditetit të sistemit bankar dhe portofolin e Bankës së Shqipërisë

Gjatë 3-mujorit të dytë të vitit 2021, portofoli i Bankës së Shqipërisë regjistroi një rënie me 100 milionë lekë pas rënies me 550 milionë lekë në 3-mujorin e mëparshëm. Vlera e portofolit të Bankës së Shqipërisë ka rënë në nivelin 67 mld lekë.

Synimi ynë ka qenë për të ruajtur një nivel të qëndrueshëm, por mospjesëmarrja e bankave tregtare në ankandet e shitblerjes me të drejta të plota të organizuara nga Banka e Shqipërisë ka sjellë këtë ulje.



1.4 Përdorimi i operacioneve rregulluese

Gjatë periudhës nuk ka pasur operacione rregulluese.

2. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2021

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Në përputhje me vendimin e Komitetit të Zbatimit dhe Këshillimit të Politikës Monetare të dt. 22 dhjetor 2020 për blerjen e 60-120 mln Euro, gjatë vitit 2021 dhe kalendarin si më poshtë të publikuar në të njëjtën datë, në 3-mujorin e dytë të vitit 2021, janë zhvilluar 4 ankande, në të cilat janë blerë 40.70 mln Euro, duke e çuar shumën totale të blerjeve në vitin 2021 në 56.80 mln.

Kalendari i ndërhyrjeve në treg

Kalendari i ndërhyrjeve - Viti 2021		
	Data	Shuma Raundi I (në euro)
1	19/02/2021	4-6 mln
2	19/03/2021	4-6 mln
3	15/04/2021	4-6 mln
4	14/05/2021	4-6 mln
5	07/06/2021	4-6 mln
6	21/06/2021	4-6 mln
7	09/07/2021	4-6 mln
8	23/07/2021	4-6 mln
9	06/08/2021	4-6 mln
10	20/08/2021	4-6 mln
11	18/10/2021	4-6 mln
12	18/11/2021	4-6 mln
13	03/12/2021	4-6 mln
14	20/12/2021	4-6 mln

* Në rastet kur ankandi bie në ditë pushimi, ankandi do të organizohet në ditën pasardhëse të punës.

Në lidhjen e mëposhtme mund të gjeni një informacion të përmblodhur mbi historikun dhe rezultatet e ndërhyrjeve të Bankës së Shqipërisë në tregun valutë

https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Operacionet_e_Bankes_se_Shqiperise/Nderhyrjet_ne_tregun_valutor/

2.3 Veprime me institucione të tjera

Gjatë 3-mujorit të dytë të vitit 2021, MFE rezulton më një total të marrëveshjeve SWAP të pa maturuara për 38.55 mld lekë

Gjatë 3-mujorit të dytë, Banka e Shqipërisë ka blerë 5.61 mln Euro nga programi IPA dhe 3.71 mln Euro nga IBRD.